

Data 15.10.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rinovimi i Suportit të Infrastrukturës Qëndrore të UKT sh.a”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Suport kompjuterik dhe shërbime konsulence 72600000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 18.979.000 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë **pa TVSH.**

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 192.095,14 (njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëdhjetë e pesë presje katërbëdhjetë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 15.10.2024 është 98.80 euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës sipas 3 konkretisht në vlerën 379.580 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë).

Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 3.841,903 (tre mijë e tetëqind e dyzet e një presje nëntëqind e tre) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 15.10.2024 është 98.80 euro.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi*.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël 7.591.600 (shtate milion e peseqind e nentëdhjete e një mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara

në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara, ose,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$18.979.000 \times 40\% = 7.591.600$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi HPE për pajisje Server ose ekuivalente.
- b. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) specialistë të çertifikuar nga Prodhuesi IBM për pajisje Storage ose ekuivalente.
- c. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Windows Server 2016 ose ekuivalente.
- d. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Exchange Server 2016 ose ekuivalente.
- e. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Microsoft Server Virtualisation ose ekuivalente.
- f. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Cisco për pajisje Rrjeti ose ekuivalente.
- g. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi HP për pajisje Rrjeti ose ekuivalente.
- h. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi BARRACUDA ose ekuivalente

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a.Kontratën e punës

b.Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

c)Punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë muajin e fundit.

Shënim: Për plotësimin e pikave të mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

a. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi HPE për pajisje Server. Vendosja e kriterit është vendosur për arsye se në specifikimet teknike është paraqitur e gjithë infrastruktura aktuale hardware në paragrafin 4.2 dhe për rrjedhojë lind nevoja e një 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi HPE për pajisje Server.(i cili do të instalojë, konfigurojë, dhe ofrojë support për pajisjet HPE Server.)

b. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) specialistë të çertifikuar nga Prodhuesi IBM për pajisje Storage. Vendosja e kriterit është vendosur për arsye se në specifikimet teknike UKT sh.a disponon pajisje IBM Storage dhe për rrjedhojë lind nevoja e një specialist të çertifikuar nga prodhuesi IBM për një suport sa më të specializuar në rastet e nevojës për ndërhyrje(ritje të kapacitetit storage, back up dhe parandalimin në kohë të defekteve që mund të ndodhin në këto pajisje).

c. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Windows Server 2016.

Vendosja e kriterit është vendosur për arsye se në specifikimet teknike është paraqitur e gjithë infrastruktura aktuale hardware në paragrafin 4.1 dhe për rrjedhojë lind nevoja e një 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Windows Server 2016, i cili do të ofrojë shërbim të mirëmbajtjes për produktet dhe platforma Microsoft (mirëmbajtje të replikimit të Domain Controller, përditësimi I Windows OS duke përdorur Windows Updates.)

d. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Exchange Server 2016. Vendosija e kriterit është vendosur për arsye se në specifikimet teknike është paraqitur e gjithë infrastruktura aktuale hardëare në paragrafin 4.1 dhe për rrjedhojë lind nevoja e një 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Microsoft për Exchange Server 2016 i cili do të ofrojë shërbim të mirëmbajtjes për produktet dhe platforma Microsoft (mirëmbajtje e 2 serverave pjesë e Exchange Cluster, mirëmbajtje dhe monitorim i Exchange 2016 DAG).

e. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Microsoft Server Virtualisation. Referuar faktit se UKT sha disponon platforma Microsoft nevojitet një specialist i certifikuar nga Prodhuesi Microsoft Server Virtualisation për të realizuar ndërtimin e Virtual Machine të nevojshme për mbarëvajtjen e netëork të brendshëm.

f. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Cisco për pajisje Rrjeti.

Vendosija e kriterit është vendosur për arsye se në specifikimet teknike është paraqitur e gjithë infrastruktura aktuale hardëare në paragrafin 4.1 dhe për rrjedhojë lind nevoja e një 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi Cisco i cili do të ofrojë shërbim të mirëmbajtjes për produktet Cisco si dhe monitorim dhe konfigurimi(ndryshimet e nevojshme) e rrjetit të ndërtuar mbi këto pajisje.

g. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi HP për pajisje Rrjeti.

Vendosija e kriterit është vendosur për arsye se në specifikimet teknike është paraqitur e gjithë infrastruktura aktuale hardëare në paragrafin 4.2 dhe për rrjedhojë lind nevoja e një 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi HP për pajisje Rrjeti.(i cili do të instalojë, konfigurojë, dhe ofrojë support për pajisjet HP Rrjeti.)

h. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi BARRACUDA.

Vendosija e kriterit është vendosur për arsye se në specifikimet teknike është paraqitur e gjithë infrastruktura aktuale hardëare në paragrafin 4.2 dhe për rrjedhojë lind nevoja e një 1 (një) punonjës të çertifikuar nga Prodhuesi BARRACUDA (i cili do të instalojë, konfigurojë, dhe ofrojë suport për pajisjet Barracuda.)

Numri i punonjësve është përlloritur sipas proceseve të punës të cilat janë përshkruar në specifikimet teknike.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.Operatori ekonomik duhet te paraqesë Certifikaten e Cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme), ose ekuivalente leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim. Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet te dorezoje certifikaten ISO sipas zerave qe do te marre persiper sipas akt-marreveshjes.)

2.4.2.Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 27001:2013 “Për **Sigurinë e Informacionit**”, ose ekuivalente, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet te dorezoje certifikaten ISO sipas zerave qe do te marre persiper sipas akt-marreveshjes.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 27001:2013 :Njohja është një nga vlerat më të rëndësishme të një organizate në sigurimin e vazhdimësisë së biznesit.Në rast se shumë pasuri janë humbur, informacioni i humbur nuk ka ekuivalent monetar. Për këtë arsye, në kushtet që ndryshojnë dhe zhvillohen sot, rëndësia e informacionit dhe domosdoshmëria e mbrojtjes po rritet gradualisht. informacionit; Ajo mund të përdoret dhe të ruhet me shkrim, media elektronike, verbale, kujtesa e punonjësve dhe shumë formate të tjera. Për shkak të përparimeve teknologjike, shumë prej këtyre formave të përdorimit mund ose nuk mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Për shkak të këtij ndryshimi dhe zhvillimi, siguria e informacionit duhet të pyetet vazhdimisht dhe kontrollohet. Siguria e informacionit është mbrojtja e konfidencialitetit, integritetit dhe përdorshmërisë së informacionit.

ISO 27001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit është një sistem menaxhimi që përfshin njerëzit, proceset dhe sistemet e informacionit në sigurimin e informacionit të korporatave të informacionit dhe mbështetet nga menaxhmenti i lartë. Është hartuar për të mbrojtur asetet e informacionit dhe për të siguruar kontrolle adekuate dhe proporcionale të sigurisë që i japin besim palëve të interesuara. Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit

ISO 27001 përfshin strukturën e korporatave, politikat, aktivitetet e planifikimit, përgjegjësitë, aplikacionet, procedurat, proceset dhe burimet.

2.4.3.Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi IBM i produkteve Storage apo distributori i autorizuar nga prodhuesi IBM i produkteve Storage.Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin IBM apo me distributorin e autorizuar nga prodhuesi IBM.

2.4.4.Operatori ekonomik duhet të jetë Servis i Autorizuar nga Prodhuesi HP i produkteve Server apo distributori i autorizuar nga prodhuesi HP i produkteve Server.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori duhet të paraqesë Kontratën e Servisit të lidhur me prodhuesin HP apo me distributorin e autorizuar nga prodhuesi HP.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në bazë të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe njoftimit të APP-së nr.prot 7459/4, datë 25.05.2021.

Lidhur mbi vendosjen e kriterëve të mësipërme sqarojmë si më poshtë vijon:

Sistemet informatike të ngritura vitet e fundit në UKT janë kritike për vetë ndërmarrjen si dhe për klientet e UKT sh.a. Informacioni që mbledhet dhe përpunohet me anë të këtyre sistemeve është shumë i rëndësishëm jo vetëm për vendimmarrjen por dhe për menaxhimin e të ardhurave dhe buxhetit të UKT dhe Bashkisë Tiranë.

Nisur nga rëndësia e këtyre sistemeve dhe shërbimeve të ngritura mbi to, si dhe bazuar mbi termat e lëvrimit të shërbimit të prodhuesve apo të distributorëve të infrastrukturës, grupi i hartimit të specifikimeve teknike bazuar dhe mbi informacionet e mbledhura nga sitet zyrtare të prodhuesve, ka hartuar termat e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit, publikuar në faqen zyrtare të APP. Këto terma mbështeten mbi parimin e garantimit të disponueshmërisë maksimale të mundshme të shërbimeve, duke i kërkuar operatorit ekonomik ofertues ndërhyrjen e menjëhershme, për të siguruar zgjidhjen e problemeve brenda një kohe sa më të shkurtër dhe të pranueshme, pa penguar në mënyrë domethënëse shërbimet kritike të UKT sh.a.

Mbështetja nga prodhuesi ose distributori suporti dhe diagnostikimi në ambientet e klientit, zëvendësimi i pjesëve të difektuara, dhënia e aksesit në shërbimet dhe informacionet elektronike të shitësit, ndjekja e problemit deri në zgjidhjen përfundimtare jepet vetëm me anë të partnerëve zyrtarë të zgjedhur dhe të miratuar nga prodhuesi ose distributori të cilët kanë staf të certifikuar nga prodhuesi, si dhe janë në gjendje të lëvrojnë pjesë këmbimi origjinale brenda afateve kohore të përcaktuara nga MNSH, përndryshe prodhuesi ose distributori nuk mban asnjë përgjegjësi për garancitë apo probleme të tjera të mundshme.

Sensitiviteti i sistemeve në fjalë kërkon ndërhyrje të shpejta dhe efikase, disponibilitet në kohë dhe në kapacitete teknike.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në specifikimet teknike(pjesë e DST-së) janë përcaktuar edhe arsyet e vendosjes të specifikimeve teknike.

Njesia e prokurimit